



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, bën:

**Shpallje të Konkursit Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

| | |
|--------------------------|--|
| Titulli i punës: | Ekspert në fushën e Legjislacionit |
| Numri i referencës: | MIN -3 - 2018 /MSHV |
| Tarifa e shërbimit: | E negociuar |
| Raporton : | Sekretari i Përgjithshëm |
| Lloji i kontratës: | Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV) |
| Kohëzgjatja e kontratës: | 3 muaj me mundësi vazhdimi edhe 3 muaj |
| Orari i punës: | I plotë |
| Numri i ekzekutuesve: | 2 (dy) |
| Vendi: | Prishtinë |

Detyrat dhe përgjegjësitë e të angazhuarit për MSHV:

1. Ofron mbështetjen profesionale ne hartimin, zhvillimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike ne fushën e inovacionit dhe ndermarresise.
2. Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhen me aktet normative brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e ministrisë;
3. Siguron pajtueshmërinë e projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me Kornizën Kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian ;
4. Ndihmon ne hartimin e akteve tjera juridike, kontrata, marrëveshje nga fushë veprimtaria e ministrisë, metodologji dhe procedura për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit si dhe jep opinione ligjore;

Shkathësitë e kërkua:

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Njohuri mbi procedurat administrative;
- Aftësi për punë me kompjuter (Word, Excel, Outlook dhe Internet)
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Afati i konkurrimit është prej datës 06/04/2018 deri me date 13/04/2018 deri në orën 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Ndërtesën e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, ose mund të tërhiqen nga web faqja e MIN-së në adresën

<http://www.min-rks.net> dhe dorëzohen në adresën: Ndërtesa e Punëve të Jashtme, kati i tretë – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 00381 38 200 69 507.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.